



Më
Dana

09-10-18

[Signature]

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:042031
Datë: 08.08.2018
Numri i dokumentit: 00112523

P.nr.890/2014

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari Adem Shabani, me procesmbajtësen-praktikanten Marigona Shaqiri, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDACTED], nga Fshati [REDACTED] Komuna Shtime, për shkak të veprës penale “vjedhja e shërbimeve komunale” nga neni 320 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.841-1/14 e dt.13.08.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në prani të përfaqësuesit të akuzës-prokurorit të shtetit Burim Qerkini, të akuzuari, me dt. 08.08.2018 solli dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari [REDACTED] nga Fshati [REDACTED] Komuna, Shtime, i lindur më [REDACTED] në të njëjtin vend, nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar baba i një fëmije, i pa punë i gjendjes së varfër ekonomike, i pa dënuar deri më tani, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTORË

Sepse:

- me datë 21 Nëntor 2013, në fshatin [REDACTED] Komuna Shtime, gjatë kontrollit nga ana e punëtorëve të KEDS-it, nën Distrikti në Shtime, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të shërbimit komunal për vete, në mënyrë që njëtori elektrik me nr. 1807962, i janë hequr blloibat shtetërore, numëruesi i njëtorit është i manipuluar, ka gjurmë të gërvishtjes së numrave në numërorë, ashtu që energjia e shpenzuar nuk është regjistruar fare, me të cilin veprim ka dëmtuar KEDS-in Distrikti në Ferizaj në shumë prej 496,94 Euro.

Me të cilën ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 41, 46, 49, 50, 51 dhe 73 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së e

GJYKON

Të akuzuarit [REDAKTUAR], i shqipton dënimin me kusht me gjobë në shumë prej 100 / njëqind / Euro, dhe dënim me kusht me burg prej 4 (katër) muajve, pra të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari në afatin prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen veprën tjetër penale.

Përfaqësuesi i KEDS-it Distrikti në Ferizaj për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i akuzuari të paguaj shpenzimet e procedurës penale-paushallin gjyqësor në shumë prej 20 €, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Për pagesën e taksës në shumën prej 30 Euro, konform nenit 39 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimin, e ka liruar nga pagesa për arsye se gjendjen ekonomike e ka të vështirë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj ka paraqitur aktakuzën Ferizaj PP/II.nr.841-1/14 e dt.13.08.2015, me të cilën ka ngarkuar të akuzuarin [REDAKTUAR] nga Fshati [REDAKTUAR], Komuna, Shtime, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 par.1 të KPRK-së.

Gjykata bazuar në nenin 311 paragrafi 3 të KPPRK-së në fillim të shqyrtimit gjyqësor e njofton prokurorin e shtetit dhe të pandehurin se nga shqyrtimi i fundit gjyqësor shtyrja ka kaluar më shumë se tre (3) muaj, shqyrtimin gjyqësor duhet të filloj rishtas dhe përsëri të shqyrtohen të gjitha provat, por prokurori i shtetit dhe i pandehuri pajtohen që të lexohen provat të cilat janë nxjerrë më parë gjatë seancave gjyqësore.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor me dt. 08.08.2018, në të cilin gjyqtari ka ftuar të akuzuarin të përcjellë me vëmendje zbatimin e shqyrtimit gjyqësor duke e udhëzuar të akuzuarin në kuptim të nenit 323 parag.2.1,2.2 dhe 2.3 të KPPK-së.

Prokurori i shtetit Burim Qerkini në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se pas administrimit të provave e posaçërisht të deponimit të dëshmisë së dëshmitarit vërtetohet fakti se i akuzuari ka kryer veprën penale që akuzohet, i ka propozuar gjykatës që të njëjtit të shpallë fajtorë dhe të shqiptoi sanksion penal të paraparë me ligj, ndërsa me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit si rrethana lehtësuese të akuzuarit të merr, dhe gjendjen e tij të varfër ekonomike.

Të akuzuarit [REDAKTUAR] edhe në shqyrtimin gjyqësor të radhës i është dhënë mundësia të deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë e tij për veprën për të cilën është akuzuar dhe i njëjti ka deklaruar se nuk e ndien veten fajtorë dhe nuk e pranon fajësinë.

Pasi i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë në fillim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ka ftuar prokurorin e shtetit për të përmbledhur provat që mbështesin rastin konform nenit 328 par 1. të KPPK-së.

Konform nenit 329 gjykata ka bërë prezantimin e provave që i ka konsideruar të rëndësishme për një gjykim të saktë dhe të drejtë.

I akuzuari [REDAKTUAR] shqyrtimin gjyqësor në mbrojtjen e dhënë ka deklaruar se është e vërtetë se pronari i shtëpisë [REDAKTUAR] nuk jeton në Kosovë por me familje jeton në shtetin e Francës dhe par tij në shtëpinë e tij kanë ndjekur persona tjerë kurës nga viti 2008-2009 vëllai i [REDAKTUAR] i ka thënë se a mundesh të hysh në këtë shtëpi të banosh dhe ta ruash ku ka pranuar pasi e ka fqinjë dhe i ka premtuar se për roje do të paguhet. Për veprën penale që akuzohem se, i janë hequr bllobat shtetërore, numëruesi i njëisorit është i manipuluar, ka gjurmë të gërvishjes së numrave në numërorë, ashtu që energjia e shpenzuar nuk është regjistruar fare është e vërtetë se ka qenë njehsori i vjetër i vendosur aty por ky nuk e ka prekur pasi aty kanë banuar persona të tjerë dhe ky ka qëndruar në këtë shtëpi deri në fund të vitit 2017, dhe nga punëtorët e KEDS-it është hequr njehsori i vjetër dhe është vendosur njehsori i ri por tani aty nuk banon dhe nuk është shfrytëzues i energjisë elektrike. Borxhin që më kërkon KEDS-i se i kam shkaktuar dëm nuk do ti paguaj se nuk i ka borxh.

Në shqyrtimet gjyqësore të mbajtura me datën 27.05.2015, në cilësinë e dëshmitarit ka dëgjuar [REDAKTUAR] punëtor i Qendrës së Kalibrimit në Prishtinë, dhe në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datën 14.07.2017, ishte dëgjuar dëshmitari i KEDS-it, [REDAKTUAR], lexuar procesverbalit DMEE me nr.24/21 i datës 21.11.2013, procesverbali me nr.0782732 i dt.26.12.2013 si dhe shikimi i fotografive të cilat gjenden në shkresat e kësaj lënde penale. Pas kësaj gjykata ka bërë administrimin e provave ku ka lexuar provat të cilat i kishte administruar në shqyrtimin gjyqësor me datën 08.08.2018.

Në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datën 27.05.2015 Dëshmitari [REDAKTUAR] punëtor i KEDS-it nga Qendra e Kalibrimit në Prishtinë në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se njësorët elektrik në Qendër vinë pa emër dhe mbiemër vetëm me numër të njëisorit elektrik dhe komisioni ka konstatuar se njësorit elektrik nr.1807962, ka qenë pa blloba dhe gjatë ekzaminimit është konstatuar se ka gërvishje në numrat e numërorit.

Në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datën 14.07.2015 dëshmitari [REDAKTUAR] ka deklaruar se me urdhrin e koordinatorit [REDAKTUAR] kanë shkuar tek shtëpia e [REDAKTUAR] ku shfrytëzues ishte i pandehur [REDAKTUAR] ku kishin shkuar për të regjistruar pajisjet elektrike por dera e shtëpisë ishte e mbyllur dhe nuk kanë kontaktuar me asnjë person por kanë vërejtur kabllon që ishte e lidhur jashtë njehsorit elektrik dhe kanë pyetur fqinjët se kush është për momentin duke e shfrytëzuar këtë shtëpi i kanë thënë se aty shfrytëzues është [REDAKTUAR].

Dëshmitë e dëshmitarëve, paraqitja e kallëzimit penal nga ana e KEDS-it m nr.DFE 9012341 të DT.24.11.2014, procesverbali me nr.1747181 i dt.24.11.2014, fatura me nr.408909 e dt.28.11.2014, dhe fotografit që gjenden në shkresat e lëndës gjykata vlerëson si objektive dhe reale dhe ju shprehu besimin e plotë.

Gjykata vlerëson mbrojtjen e të akuzuarit [REDAKTUAR] se nuk është kryes i veprës penale që akuzohet pasi gjykatës nuk i ka sjellë prova apo dëshmi por deklarimi i tij ishte ikjes së përgjegjësisë penale dhe gjykata nuk e aprovoj një mbrojtje të tillë pasi një mbrojtje e tillë ishte e orientuar ikjes së përgjegjësisë penale pasi.

Gjykata kishte ftuar me ftesa të rregullta që të dëgjohet në cilësinë e dëshmitarit edhe pronarin e shtëpisë [REDAKTUAR] por nga flet kthesat për dorëzim personal shpërndarësi i ftesave ka cekur se ai nuk gjendet në Kosovë por në Francë me familje .

Duke i vlerësuar provat e zbatuara në procedurë në bazë të nenit 361 par.1 dhe 2 të KPPK-së gjykata nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit përfshihen të gjitha tiparet e veprave penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 par.1 të KPRK-së.

Provat e lartcekura në tërësinë e tyre janë në harmoni dhe plotësohen reciprokisht dhe të cilat në unitetin e tyre pasqyrojnë një të vërtetë të plotë.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK së të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin mori gjendjen jo të mirë ekonomike, i martuar baba i një fëmijë punon privat, mbi bazën e këtyre rrethanave gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe rrezikshmërinë konkrete të kësaj veprë penale, dhe në kuptim të të gjitha këtyre, i shqipton dënimin me kusht si në dispozitiv të aktgjykimit duke qenë e bindur se një dënim i tillë është në proporcion dhe raport me peshën e veprës konkrete penale, rrethanave të kryerjes si dhe personalitetin e të akuzuarit dhe me të arrihet qëllimi ndëshkues në kuptim të preventivës speciale që i akuzuari të mos kryejë vepra penale si dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të kësaj veprë penale në shoqëri konform nenit 41 të KPRK-së.

Konform nenit 463 parag.1 lidhur me par.3 të KPPK-së, të dëmtuarën KEDS-it Distrikti në Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike i ka udhëzuar në kontest civil

Vendimi mbi kompensimin e paushallit gjyqësor është sjellë në bazë të nenit 450 par.2 nënpar.2.6 të KPPK-së.

Konform nenit 453 par.4 të KPPK-së të akuzuarin e ka liruar në tërësi nga detyrimi i pagesës së shpenzimeve të procedurës penale pasi nëse e obligon do të rrezikonte gjendjen e tij materiale.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,
P.nr.890/14 me datë 08.08.2018

Praktikante
Marigona Shaqiri

Gjyqtari
Adem Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundë të ushtrohet, ankesë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.